

5.2. Testimi fizik.

5.2.1 Testimi fizik është hapi i parë i konkurrimit. Ai ka si qëllim të verifikojë standardet fizike që kandidatët duhet të plotësojnë për t'u rekrutuar si ushtarë/detarë në FA.

5.2.2 Kandidatët i nënshtrohen testimit fizik në disiplinat e mëposhtme:

- vrapim 1000 m;
- ulje-ngritje mbi krahë (pompa);
- palosje-shpalosje.

5.2.3 Testimi fizik zhvillohet nën mbikëqyrjen e Komisionit të Testimit Fizik, sipas normave të përcaktuara në **Aneksin A**, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

5.2.4 Kandidati për ushtar/detar aktiv duhet të marrë minimumi **60 pikë në çdo disiplinë** testimi.

5.2.5 Në rastet kur kandidatët pas testimit renditen poshtë këtij kufiri dhe numri i kandidatëve kundrejt kuotave të planifikuara nuk plotësohet, kriteri i sigurimit të minimumit 60 pikë në çdo disiplinë nuk aplikohet. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet sipas listë-renditjes deri në plotësimin e numrit të kërkuar. Pikët e përfituara nga kandidati do të konsiderohen në përzgjedhjen e dhe shpërndarjen e tyre sipas forcave/specialiteteve.

5.2.6 Në testin fizik kandidati duhet të paraqitet me veshje sportive të siguruara prej tij (bluzë e pantallona të shkurtra/tuta) dhe këpucë sportive (atlete).

5.2.7 Testimi fizik zhvillohet në prani të ambulancës dhe ekipit mjekësor. Ai zhvillohet në disa sesione dhe për disa ditë.

5.2.8 Pas çdo sesioni të testimit fizik, kandidatët listohen sipas pikëve. Listat e rezultateve, pasi firmosen nga anëtarët e komisionit, i dërgohet komandantit të QPR-së dhe hidhen brenda ditës në Sistemin e Automatizuar të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Rezultatet u bëhen të ditura kandidatëve;

5.2.9 Pas përfundimit të testimit fizik nëpërmjet Sistemit të Automatizuar të Burimeve Njerëzore gjenerohet "Raporti i rezultateve të testimit fizik". Raporti përmban: nr., emrin, atësinë, mbiemrin e kandidatit, gjatësinë, gjininë (mashkull ose femër), disiplinat e testimit, normat e arritura dhe sasinë e pikëve për çdo disiplinë, pikët totale të marra në testimin fizik.

(marrë nga [Udhëzim nr. 5, datë 10.10.2022, për "Procedura dhe kriteret e rekrutimit të ushtarëve/detarëve aktivë në Forcat e Armatosura"](#))